



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ - DEGA E GJYKATËS KAÇANIK

Numri i lëndës: 2021:017348

Datë: 16.08.2024

Numri i dokumentit: 06056860

P.nr.45/21

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ-DEGA KAÇANIK, Departamenti I Përgjithshëm-Divizioni Penal, Gjyqtarja Zajrete Muhaxheri, me sekretaren juridike Indira Beqa, në çeshtjen penale ndaj të pandehurit M.K nga Ferizaj, i akuzuar për veprën penale, Sulmi nga neni 184 par.1 të KPRK-së dhe veprën penale, Lëndim I rëndë trupor nga neni 186 par.3 nënpar.3.1 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Ferizaj, PP/IL.nr.78/21 të datës 12.02.2021, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor me dt.27.06.2024, në prezencë të prokurorit të shtetit Dardan Çela, mbrojtësit të të dëmtuarit, D. V., av.Sh. V., dhe të pandehurit me mbrojtësen e tij me autorizim, av.A. Sh., në mungesë të të dëmtuarve: D. V. dhe V. K., me dt.02.07.2024 mori dhe shpalli publikisht, ndërsa me dt. 24.07.2024 përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I pandehuri M.K nga Ferizaj, me adresë banimi në rr.”...” nr., i lindur më dt...., nga i ati A... dhe e ëma M..., e gjinisë D..., shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, i pa martuar, ka të kryer shkollën fillore, I pa punë , i gjendjes së dobët ekonomike, me nr.personal: ...

ËSHTË FAJTOR

1.Sepe me dt.28.12.2020, rreth orës 20:25, në rrugën “Ismajl Raka” në Kaçanik, pikërisht në lokalin “...”, me dashje e përdor forcën ndaj të dëmtuarit V. K., në atë mënyrë që derisa i dëmtuari ishte duke qëndruar në lokal, fillojnë mosmarrëveshjet në mes të pandehurit Sh...me të dëmtuarin lidhur me një vajzë, pastaj i pandehuri M... e godet të dëmtuarin me grushte në fytyrë në pjesën e syrit.

Me këtë veprim i pandehuri ka kryer veprën penale, Sulmi nga neni 184 par.1 të KPRK-së.

Sepse me datën, kohën dhe vendin e cekur si në dispozitivin e parë, me dashje dhe me një mjet të rrezikshëm, i shkakton lëndime të rënda trupore të dëmtuarit D. V., në atë mënyrë që derisa i dëmtuari ishte duke qëndruar në lokal, fillojnë mosmarrëveshjet në mes shokut të tij V.K. dhe të pandehurit Sh..., ku i dëmtuari D... ka ndërhyrë që t'a qetësojë situatën, pastaj i pandehuri M... e godet me thikë në pjesën e krahut të dëmtuarin dhe tenton prap që ta godas por ndalohe nga disa persona aty në lokal, megjithatë i njëjti i shkakton lëndime të rënda trupore të përshkruara si në ekspertizën mjekoligjore të dt.09.02.2021,

Me këtë veprim i pandehuri M.K, ka kryer veprën penale, Lëndim i rëndë trupor nga neni 186 par.3 nënpar.3.1 të KPRK-së.

Prandaj gjykata në bazë të nenit 2,7,38,42,43,69,70 dhe 71 par.1 nënpar.1.3 dhe nenit 72 par1 nënpar.1.5, të KPRK-se, si dhe nenit 358,359,360 dhe 364 të KPP-së, e

GJYKON

1.Për veprën penale si në pikën I të dispozitivit të aktakuzës, me dënim me gjobë në shumë prej 450.00 € (katërqind e pesëdhjetë euro).

Për veprën penale si në pikën I të dispozitivit të aktakuzës me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 180 ditësh.

Konfor nenit 76 par.2 nënpar.2.5 të KPRK-së, të pandehurit i shqiptohet dënimi unik me gjobë në shumë prej 450.00 (katërqind e pesëdhjetë euro) dhe dënim me burgim në kohëzgjatje prej 180 ditësh.

Dënimi me burgim do të ekzekutohet pasi që ky aktgjykim të merr formën e prerë, ndërsa obligohet I pandehuri që dënimin me gjobë t'a paguajë brenda afatit prej 30 ditësh, por jo me gjatë se dy muaj pasi që ky aktgjykim të merr formën e prerë dhe ate në dy këste.

Nëse i pandehuri nuk e paguan gjobën , gjykata do t'a zevendesojë dënimin me gjobë me dënim me burgim duke llogaritur shumen prej 20 € për çdo ditë burgu.

Detyrohet i pandehuri që në emër të paushallit gjyqësor të paguajë pranë kësaj gjykate shumën prej 50,00 € , ndërsa në emër të taksës për Fondin e Kompensimit të Viktimave të Krimit ne shume prej 20.00€, te gjitha keto paguhen pasi qe ky aktgjykim te merr formën e prerë, nën kërcënimin e përmbartimit me dhunë.

Të dëmtuarit: V.K. dhe D. V., për realizimin e kërkesës pasurore juridike, udhëzohen në kontest civil.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Ferizaj, ka parashtruar pranë kësaj gjykate aktakuzën, PP/II.nr.78/21 të dt.12.02.2021, kundër të pandehurit M.K nga Ferizaj, për shkak të veprës penale, Sulmi nga neni 184 par.1 të KPRK-së dhe veprës penale, Lëndim I rëndë trupor nga neni 186 par.3 nënpar.3.1 të KPRK-së, dhe kundër të pandehurit Sh. K., për shkak të veprës penale, Sulmi nga neni 184 par.2 të KPRK-së.

Ne bazë të kësaj aktakuze, gjykata ka caktuar dhe mbajtur shqyrtimin fillestar me dt.24.05.2022 me te cilin rast, pas prezentimit te aktakuzës nga prokurori I shtetit, I pandehuri M.K, e ka pranuar fajësinë për veprën penale për të cilën akuzohet, ndërsa I pandehuri Sh. K., nuk e ka pranuar fajësinë për veprën penale për të cilën akuzohet.

Me dt.27.06.2024, gjykata caktoi dhe mbajti senacën e shqyrtimit gjyqësor, me të cilin rast, pasi që Gjykata konstatoi, përmes njoftimit të Stacionit Policor në Kaçanik, se I pandehuri Shpejtim Krraba gjindet jashtë vendit, për hir të efikasitetit të procedurës penale, bëri veqimin e procedurës penale për të pandehurin Sh. K. I akuzuar për veprën penale, Sulmi nga neni 184 par.2 të KPRK-së, në mënyrë që të formohet lëndë e re dhe të gjykohet veqmas nga I pandehuri M.K.

Prokurori I shtetit Dardan Çela, në shqyrtimin gjyqësor, të vazhduar vetëm për të pandehurin M.K, në fjalën e tij mbeti në tërësi pranë aktakuzës të parashtruar me shkrim pranë kësaj gjykate. Në fjalën përfundimtare ka theksuar se, gjatë shqyrtimit gjyqësor, është vërtetuar pa mëdyshje fajësia e të pandehurit M.K, për veprat penale për të cilat e ngarkon aktakuza e Prokurorisë, kjo duke u bazuar në pranimin e fajësië nga ana e të njejtit, pranim ky I cili ka mbështetje edhe ne provat personale dhe materiale që përmban aktakuza, dhe se në rastin konkret nuk ka asnjë rrethanë e cila e liron nga përgjegjësia penale të pandehurin në fjalë. Andaj i propozon gjykatës që të njëjtin t'a shpall fajtor dhe t'i shqiptojë një sanksion penal meritor sipas ligjit, ndërsa në pajtim me nenin 69 dhe 70 të KPRK-së, me rastin e caktimit dhe llojit të dënimit të merr parasysh si rrethanë rënduese shkallën e lartë të dashjes, intensitetin e rrezikimit apo dëmtimit të vlerës së mbrojtur, kur merret parasysh që në këtë rast është rrezikuar dhe dëmtuar integriteti trupor i të dëmtuarve, për të cilat ofrohet mbrojtja e veqantë juridiko penale, ndërsa si rrethanë lehtësuese i propozon gjykatës që të merr parasysh pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit. Poashtu i propozoë gjykatës që i pandehuri të obligohet në pagesën e shpenzimeve penale, dhe poashtu i propozon gjykatës që para se t'i shqiptojë një dënim të bëjë edhe verifikimin e të kaluarës përmes sistemit qendror të evidencës penale .

Mbrojtësi me autorizim i të dëmtuarit D. V., av.Sh. V., në fjalën e tij në shqyrtimin gjyqësor, e mbështet ne tërësi fjalën përfundimtare të prokurorit të shtetit, ndërsa kërkesën pasurore juridike do t'a realizojnë në contest civil.

Mbrojtësja me autorizim e të pandehurit M.K, av.A. Sh., ne fjalën e saj përfundimtare deklaronte se, meqenëse i mbrojturi I saj e ka pranuar fajësinë qysh në shqyrtimin fillestar, e këtë pranim e ka bërë në mënyrë vullnetare duke i ditur pasojat, e poashtu edhe benifitet e këtij pranimi, prandaj edhe I propozon gjykatës që gjatë vlerësimit të kësaj çështje lidhur me caktimin dhe llojin e dënimit, të vlerësojë këto rrethana lehtësuese: e para si rrethanë veqanarisht lehtësuese, pranimi i fajësisë, pendimi dhe kërkim falja, fakti se nga data e ngjarjes respektivisht 28.12.2020

i mbrojturi I saj, me të dëmtuarin nuk kanë patur asnjëherë ndonjë mosmarrëveshje në mes tyre, e po ashtu në emër të të mbrojturit të saj deklaroi se është i gatshëm që palët e dëmtuara t'i kompenzojë për dëmin që është shkaktuar, rrethanë tjetër edhe bashkëpunimi i pergjishëm me gjykatën, në përgjithësi institucionet e Drejtësisë, moshën e re të pandehurit, dhe mbi këto rrethana I propozoi gjykatës që t'i vlerësojë më me peshë se sa rrethanat rënduese që i propozoi Prokurori, duke i dhënë edhe një mundësi të rehabilitimit dhe rikthimit në shoqëri, meqenëse edhe me një dënim nën minimumin e paraparë do të arrihet qëllimi i dënimit.

I pandehuri M.K në fjalën përfundimtare e mbështet në tërësi fjalën e mbrojtëses së tij dhe shton se e ndien veten të penduar për veprimet e tij, për të cilat veprime edhe e ka pranuar fajësinë që në seancën e shqyrtimit fillestar, dhe duke qene se pas këtij rasti I ka rregulluar raportet me të dëmtuarit apo kanë arrit marrëveshje që problemet mos të vazhdojnë me tutje, gjë që edhe nuk ka ndodhur ndonjë mosmarrëveshje tjetër dhe duke i premtuar gjykatës se as ne te ardhmen nuk do te përsërisë veprime te tilla ,njeherit i kërkon gjykatës që me rastin e marrjes së vendimit t'i shqiptohet një dënim sa më i ulët që të jetë e mundur .

Nisur nga kjo gjendje e vërtetuar në procedurë, gjykata gjeti se në veprimet e të pandehurit, M.K, manifestohen të gjitha tiparet e veprës penale, Sulmi nga neni 184 par.1 të KPRK-së dhe veprës penale, Lëndim I rëndë trupor nga neni 186 par.3 nënpar.3.1 të KPRK-së.

Me rastin e caktimit të dënimit gjykata pati parasysh të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese, konform nenit 70 të KPRK-së, kështu që si rrethanë lehtësuese gjykata mori faktin se i pandehuri e ka pranuar fajësinë për veprat penale për të cilat e ngarkon aktakuza në seancën e shqyrtimit fillestar, ka premtuar para gjykatës se në të ardhmen nuk do të përsërisë veprime te tilla, se pas këtij rasti, nuk ka patur ndonjë problem tjetër me të dëmtuarit, ndërsa si rrethanë të posaçme rënduese gjykata gjeti faktin se, bazuar në evidencën e gjykatës I njejt, në të kaluarën, ka qenë I dënuar me aktgjykim të formës së prerë për vepër penale, Lëndim I lehtë trupor nga neni 185 të KPRK-së, duke u gjykuar me dënim me burgim dhe dëmin e shkaktuar të dëmtuarve e sidomos të dëmtuarit D. V., I cili I kishte pësuar lëndime të rënda trupore, në momentin kur kishte tentuar që t'a qetësojë situatën në mes të pandehurit Shpejtim dhe të dëmtuarit V. K., pra duke mos qenë I përfshirë në mosmarrëveshjet e tyre të mëhershme.

Andaj gjykata, për këto arsye, të pandehurin M.K, i akuzuar për veprën penale, Sulmi nga neni 184 par.1 të KPRK-së dhe veprën penale, Lëndim I rëndë trupor nga neni 186 par.3 nënpar.3.1

të KPRK-së, e gjykoj me dënim si në dispozitiv, duke vlerësuar se dënimi i caktuar është në proporcion me veprën si dhe sjelljen e të pandehurit, dhe se dënimi i shqiptuar është adekuat me intensitetin e rrezikimit të vlerave të mbrojtura, personalitetin e të pandehurit, andaj edhe konsideron se ky dënim do të ndikojë tek i pandehuri dhe personat tjerë që të shmangen nga kryerja e veprave penale, dhe të forcojë detyrimin për respektimin e ligjit, dhe me këtë edhe të arrihet në tërësi qëllimi i dënimit, i paraparë në nenin 38 të KPRK-së.

Vendimi për shpenzimet e procedurës është i bazuar në dispozitën e nenit 449 të KPP-së.

Vendimi për taksën në emër të Fondit për Kompensimin e Viktimave të Krimit është marrë konform nenit 36 par.3 nenpar.3.1 të Ligjit për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Vendimi për kërkesën pasurore juridike, është i bazuar në dispozitën e nenit 462 par.2 të KPP-së.

Nga të cekurat e mësipërme u vendos si në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ
DEGA KAÇANIK
P.nr.45/21 datë 24.07.2024

Sekretarja juridike
Indira Beqa

Gjyqtarja,
Zajrete Muhaxheri

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi mundet të ushtrohet ankesë në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit. Ankesa i drejtohet Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate.